

Emri i Lëndës : E Drejtë dhe Politike Penale Evropiane

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 502	C	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	4.00

Lektori	Denard Veshi, Prof. Asoc. Dr.
Asistenti	Erisa Datja, MSc
Gjuha e kursit	Shqip
Niveli i lëndës	Program i Integruar
Përshkrimi	Lënda e Drejtë dhe Politika Penale Evropiane trajton ne thelb të saj tema të cilat lidhen me sistemin e drejtësisë, parimet dhe praktikët e drejtësisë penale, si dhe aspektet e politikës penale që formësojnë dhe rregullojnë veprimet e institucioneve të drejtësisë penale, rregullat, politikat dhe praktikët penale që zbatohen në nivel evropian. Kjo lëndë trajton bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mekanizmat e krijuar për të luftuar krimin, veçanërisht krimin e organizuar dhe krimin transnacional, duke respektuar standardet e të drejtave të njeriut.
Objektivat	Lënda synon të njohë studentin me te gjitha masat ligjore dhe institucionale te marra nga shteti ne parandalimin dhe luften ndaj kriminalitetit, si dhe rolin dhe efektivitetin e tyre. Ajo synon te njohë studentin me politikat penale qe zbaton shteti ne parandalimin dhe ndeshkimit e llojeve te ndryshme te krimeve.
Konceptet Kryesore	

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Kuptimi dhe Parimet e Drejtësisë Penale: Tema trajton ne vecanti: Parimi i ligjshmërisë (nullum crimen sine lege). Parimi i proporcionalitetit në ndëshkime.Parimi i të drejtës për një gjykim të drejtë (due process).Parimi i individualizimit të dënimit.Parimi i mosdiskriminimit dhe barazia përpara ligjit.
2	Politika Penale:Koncepti i politikës penale dhe evolucioni i saj.Qëllimet e politikës penale: ndalimi i krimeve, rehabilitimi i të dënuarve, ndihma për viktimat.Diferencimi i masave penale: ndëshkimi, rehabilitimi dhe rikthimi në shoqëri. Strategjitë e politikës penale për parandalimin e krimit (përfshirë masat parandaluese dhe edukimin publik).
3	Koncepti i Drejtësisë Penale Evropiane:Rëndësia e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë penale brenda Bashkimit Evropian (BE).Evolucioni i politikave dhe mekanizmave të drejtësisë penale evropiane pas krijimit të BE-së.Ndikimi i legjislacioneve kombëtare në harmonizimin e drejtësisë penale në nivel evropian.
4	Instrumentet dhe Mjetet e Bashkëpunimit Ndërkombëtar:Marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa e Strasburgut etj.).Marrëveshjet për ekstradimin dhe ndihmën gjyqësore.Sistemi ECRIS (Sistemi i Regjistrave të Dënimeve Penale të Evropës) dhe përdorimi i tij për ndihmën ndërkombëtare.
5	Krimi Transnacional dhe Krimi i Organizuar:Bashkëpunimi ndërkombëtar për luftën kundër krimit të organizuar, drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore.Instrumente evropiane për parandalimin dhe ndjekjen e krimit të organizuar (Agjencia Evropiane e Policisë, Europol).Lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në kuadër të BE-së.
6	Parimet e Drejtësisë dhe të Drejtat e Njeriut në Drejtësinë Penale Evropiane:Rëndësia e respektimit të të drejtave të njeriut në proceset penale, duke përfshirë të drejtat e të akuzuarve dhe viktimave.Karta e të Drejtave të Bashkimit Evropian dhe ndikimi i saj në drejtësinë penale.Parimet e procedurës penale evropiane dhe garantimi i një gjykimi të drejtë.

7	Harmonizimi i Legjislacioneve Penale: Rregullat dhe legjislacionet evropiane që ndikojnë në harmonizimin e ligjeve penale të shteteve anëtare. Direktivat dhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për çështjet penale. Politikat e harmonizimit të dënimeve dhe veprave penale të njohura si krime evropiane.
8	Provimi gjysmefinal.
9	Koncepti i sigurisë brenda Bashkimit Europian; Modeli evropian i sigurisë si instrument në zhvillimin ekonomik dhe reformat në Europë.
10	Emergjencat e një të drejte penale evropiane reale dhe një kodi penal evropian; Situata e krimit të organizuar në Bashkimin Europian,
11	Rreziqet nga grupet e krimit të organizuar, natyra e organizatave kriminale, Faktorët e përgjithshëm që pasqellojnë krimin e organizuar dhe terrorizmin - Procesi i inkriminimit ose kriminalizimit të ndalimeve të përgjithshme - Natyra dhe tipologjia e krimeve.
12	Trafiku i lëndëve narkotike, imigracioni ilegal, trafiku i qenieve njerezore, pornografia e fëmijëve - Krimi mjedisor, krimi kompjuterik, pirateria, skllavërimi dhe tregtia e sklleverve, prostitucioni etj - Iniciativat e Bashkimit Europian në fushën e sigurisë për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin në Europë.
13	Siguria, bashkëpunimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në shtyllën e III-te; Zgjerimi i kompetencave të Bashkimit Europian në lidhje me konceptin e ri të sigurisë - Grupet e përbashkëta të hetimit; Parimi i pranimit dhe njohjes reciproke, bashkëpunimi gjyqësor, transnacional me vendet e treta.
14	Politika kriminale ndaj femrave. Përpjekjet për të ndryshuar sjelljen shoqërore dhe kulturore: Edukimi i shoqërisë për të ulur normat e dhunshme dhe diskriminueset kundër grave është gjithashtu pjesë e politikës kriminale. Kjo mund të përfshijë fushata edukative dhe ndërgjegjësuese për të promovuar barazinë gjinore dhe për të luftuar stereotipat gjinorë. Internacionalizimi i politikave për të drejtat e grave: Pjesëmarrja në marrëveshje ndërkombëtare si Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe protokolle të tjera ndërkombëtare ka nxitur shumë shtete që të krijojnë politika dhe praktika më të avancuara për mbrojtjen e grave.
15	Politika kriminale ndaj krimit kibernetik. Ligje kundër hakimit (penetrimi i sistemeve kompjuterike pa leje). Ligje kundër mashtrimeve elektronike, përfshirë vjedhjen e informacionit bankar dhe krimet e lidhura me pagesa dhe transaksione elektronike. Legjislacion për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale (si në rastin e Rregullores Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale - GDPR). Legjislacion kundër shpërndarjes së materialeve të paligjshme, si pornografia e fëmijëve, ose përmbajtje të tjera të dëmshme.
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Mireille Delmas-Marty, "What Kind of Criminal Policy for Europe?" (Springer; 1 edition 1996) • Valsamis Mitsilegas "EU Criminal Law", Hart Publishing, 2009 • Jean Pradel, Geert Corstens and Gert Vermeulen • Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi: "Politika e luftimit të kriminalitetit" (Instituti Evropian për studime juridike dhe administrim publik "JURIDICA", Prishtinë 2012)
Referenca të tjera	• Samuli Miettinen „Criminal Law and Policy in the European Union”, 2015 • Council Framework Decision 2002/584/JHA of 13 June 2002 on the European Arrest Warrant and the Surrender Procedures between Member States • Council Decision 187/2002/JHA of 28 February 2002 setting up Eurojust with a view to reinforcing the fight against serious crime • Council Decision 2003/659/JHA of 18 June 2003 amending Decision 2002/187/JHA setting up Eurojust with a view to reinforcing the fight against serious crime • Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit 2017-2022 • Strategjia Ndërsektorale Për Luftën Kundër Krimin Të Organizuar, Trafikeve Të Paligjshme Dhe Terrorizmit 2013-2020 • Recommendation Rec(2001)11 of the Committee of Ministers to member states concerning guiding principles on the fight against organised crime (Adopted by the Committee of Ministers on 19 September 2001 at the 765 meeting of the Ministers' Deputies)
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të lëndës studenti do të njohë objektivin e politikave kriminale.
2	Në përfundim të kursit studenti do të njihet me bazën juridike të politikës kriminale, sistemin e drejtësisë, si dhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane të fushës.
3	Në përfundim të kursit studenti do të njohë politikën penale që zbatohen për dënimin dhe parandalimin e veprave penale më të përhapura.
4	Në përfundim të kursit studenti do të jetë i aftë të vlerësojë dhe analizojë reformat e ndryshme të ndërmarra në kuadër të luftës kundër kriminalitetit.
5	Në përfundim të kursit studenti do të njohë rolin që luajnë organet e drejtësisë penale, si dhe strukturat e tjera shtetërore në luftën dhe parandalimin e kriminalitetit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	5	5
Provimi final	1	5	5
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			100
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.00
ECTS			4.00